



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 3 Maj 2023

Nr: 436

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 283 ID, TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, ZJ. ALBANA VOKSHI, NDAJ DREJTORIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “TODI KOÇELI” SELENICË, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 3 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Zj. Albana Vokshi, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

**SUBJEKT:** Drejtori i Shkollës 9-vjeçare “Todi Kaçeli”, Selenicë

**OBJEKT:** Shqyrtim administrative për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar nëpërmjet portalit, denoncimi me nr. 5830 i datës 3.4.2023, nga zj. Albana Vokshi, deputete e Kuvendit të Shqipërisë, për të cilin pretendohet se ka patur përdorim të burimeve publike për qëllime zgjedhore.

Data: 3 Maj 2023

Nr: 436  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 283 ID”

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerëson se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të paraportuar në ndërfaqe.

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Subjekti objekt i këtij vendimi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

- 1- **Shkolla 9-vjeçare “Todi Koçeli”** ka publikuar 1 (një) veprimtari publike, në faqen zyrtare në “Facebook”, objekt i denoncimit të regjistruar me nr. **283 ID**, për të cilën pretendohet si vijon:
  - Denoncimin nr. **283 ID**, *“Institucioni arsimor “Todi Koçeli” Selenicë shpërndan statuse të kandidatëve në garën për zgjedhjet vendore të 14 Majit, në shkelje të nenit 91, pika 2 të Kodit Zgjedhor”*

Më datë 12.4.2023 palëve në këtë proces, ju është kërkuar informacion shpjegues në lidhje me denoncimin objekt shqyrtimi, nëpërmjet adresës së postës elektronike, por rezultoi se nuk është administruar asnjë përgjigje nga ana e palëve në proces.

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 3.5.2023, ora 12:00, ku u ftuan të gjitha palët në proces duke u dhënë të drejtën për t’u shprehur dhe nuk u paraqit asnjë prej palëve.

Provohet se në faqen zyrtare të rrjetit social "Facebook" të shkollës "Todi Koçeli", Selenicë, është ripostuar më datë 1.4.2023, postim i kandidatit për kryetar bashkie z. Nertil Bellaj, për bashkinë Selenicë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Nga verifikimet paraprake dhe provat e administruara vlerësoj që faqja e rrjetit social "Facebook", me emrin "Shkolla Todi Koçeli Selenicë", është nën administrimin drejtorit të shkollës zj. Donika Tula.

Referuar nenit 91, pika 1 e Kodit Zgjedhor *"Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia."*

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në "facebook" apo çdo mjet tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin dhe ripostimin e veprimtarive me karakter politik/elektoral në zgjedhje, nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike. Në kushtet ku nga ana e Shkollës 9-vjeçare "Todi Koçeli" Selenicë, është bërë një ripostim i një veprimtarie me karakter politik/elektoral vlerësoj se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezultoi se rasti objekt denoncimi regjistruar me nr. 283 ID dhe përbën shkelje të nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe duhet t'i tërhiqet vëmendja të personave përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në postimin dhe ripostimin e veprimtarive të ndryshme. Për rrjedhojë, referuar nenit 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor, kur shkelja nuk përbën vepër penale, *dënohet me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.*

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenit 91 dhe 171/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Data: 3 Maj 2023

Nr: 436  
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 283 ID"

## V E N D O S:

1. T'i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për zj. Donika Tula, drejtor i shkollës 9-vjeçare "Todi Koçeli" Selenicë, në vlerën 4 000 (katër mijë) lekë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 3 Maj 2023

Nr: 436  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 283 ID”